



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora
Ministër of Foreign Affairs and Diaspora

Datë: 30.03.2023

**FTESË APLIKIMI PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTPROPOZIMET**

Bazuar në Rregulloren e MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, neni 8 dhe pika 3.2, si dhe bazuar në vendimin nr. ref. 70/2023, nr. prot. 1096, i datës 15.03.2023, i lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për thirrjen publike për mbështetje financiare publike për projektpropozime të organizatave joqeveritare në fushën e diplomacisë publike, ekonomike dhe të diasporës, ftohen të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të projekteve:

- 1. përfaqësues nga OJQ-të** (një anëtar);
- 2. ekspert në vlerësimin projekteve** (një anëtar).

Përfaqësuesit e lartcekur do të jenë anëtarë të komisionit për vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave joqeveritare (OJQ) në fushën e diasporës, të pranuar nga MPJD-ja sipas thirrjes publike, e shpallur më 15.03.2023.

**Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e
përgjithshme të ftesës publike:**

1. të kenë përvojë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. të kenë përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;

3. t'i njohin dokumentet strategjike dhe politikat në fushën e diplomacisë dhe të diasporës;
4. ta njohin bazën ligjore në fuqi në fushat që mbulon ftesa publike;
5. t'i njohin metodologjitë vlerësuese në komisione të ngjashme;
6. të kenë njohuri rreth dokumenteve të tjera relevante në fushën, për të cilën është hapur ftesa publike;
7. njohje e legjislacioni në fushën e mbështetjes financiare.

Periudha e angazhimit do të jetë sipas afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren MF – nr.-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pagesa do të jetë 430 euro për anëtar.

Afati për aplikim është 5 ditë, nga data 30.03.2023 deri më 03.04.2023, në orën 14.00.

CV-të duhet të dërgohen në e-mail adresën: elis.badalli@rks-gov.net - në subjekt të shkruhet **pozita për anëtar të komisionit, për të cilën aplikoni.**

*Aplikoj si përfaqësues nga OJQ-të
apo
Aplikoj si ekspert në vlerësimin projekteve*

***Me respekt,
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës***